

---

---

## RECENSIONE

---

---

**MEMLI KRASNIQI: “KOSOVA (1981-1989): FILLIMI  
I SHPËRBËRJES SË RSF TË JUGOSLLAVISË”,  
Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2021, 358 f.**

Të paktë janë kombet që kanë përjetuar gjatë historisë kaq shumë momente kthesash dramatike sa shqiptarët. Të gjendur shpesh në udhëkryqe gjeopolitike, shqiptarëve u është dashur të ndërmarrin aksione e të bëjnë sakrifica të vazhdueshme për të siguruar mbijetesën e tyre. Në këtë përpjekje e luftë të vazhdueshme për ruajtjen e identitetit kombëtar, dinjitetit njerëzor dhe mbijetesës nga presionet e vazhdueshme të nacionalizmave sllavë, në mënyrë të veçantë atij serb, shqiptarët e mbetur jashtë kufijve shtetërorë, veçanërisht ata të Kosovës kanë shenjuar një histori të jashtëzakonshme. Shumë është shkruar për Kosovën e viteve ‘80, por me sa duket, asnjëherë mjaftueshëm. Në këtë panoramë, punimi më i ri i prof. assoc. dr. Memli Krasniqi është një dritare tjetër që hapet dhe një kontribut i vlerësuar.

Nuk ka dyshim se vitet ’80 të shek. XX janë ato më dinamiket dhe më vendimtare për fatin e Kosovës, kësaj toke të shkëputur brutalisht nga trungu kombëtar shqiptar që prej vitit 1913. Vështirësitë për hartimin e një punimi të tillë kthehen në sfida, me të cilat duhet të përballet çdo studiues. Fillimisht sfidat janë objektive dhe lidhen me hulumtimin e mijëra faqesh dokumentacioni, të shpërndara në arkiva të ndryshëm, por edhe literatura që duket e pashtershme. Kolegu Krasniqi e ka kapërcyer këtë sfidë duke na sjellë burime të shumta parësore të vjela nga arkivat e Kosovës, Sllovenisë e Beogradit, si dhe duke shfrytëzuar literaturën relevante të shkruar nga autorë shqiptarë dhe të huaj.

Sfida e dytë, më e vështira, është ajo subjektive. Të shkruash për ngjarje të cilat në një moment të jetës i ke përjetuar në vetë të parë, i kërkojnë studiuesit të punojë shumë me veten për të shmangur qasjet emocionale dhe për të krijuar një narrativë historike sa më profesionale. Më shumë akoma, ndërtimi i një narrative shkencore për ngjarje historike, në të cilat protagonistët janë ende aty për të gjykuar (shpeshherë edhe emocionalisht) çdo fjalë e tezë të hedhur, përbën një

vështirësi jo të vogël për çdo studiues. Më duhet të përgëzoj kolegun Krasniqi, pasi ka arritur t'i kapërcejë me profesionalizëm këto sfida duke na sjellë një punim të mirëdokumentuar, të mirargumentuar dhe mjaft profesional.

Monografia “Historia e Kosovës (1981-1989): prishja e *status quo*-së dhe hapja e rrugës për zgjidhjen e konfliktit shqiptaro-serb” është një analizë e thelluar jo vetëm historike, pasi autori i ka dhënë studimit të tij karakter ndërdisiplinor. Autori ka analizuar sa pozicionin gjeopolitik të Jugosllavisë si një shtet i paangazhuar në kontekstin e Luftës së Ftohtë, aq edhe ndikimin e Shqipërisë në ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve të Kosovës; sa aspektet juridike dhe organizimit kushtetues të Federatës Jugosllave dhe Krahinës Autonome të Kosovës në veçanti, aq edhe problematikave ekonomike, kulturore e arsimore të Kosovës. E gjithë analiza politike-juridike, diplomatike, ekonomike e historisë së Kosovës është trajtuar në raport krahasimor me republikat që përbënin Federatën Jugosllave.

Faqe pas faqesh punimi i prof. Krasniqit paraqet teza dhe trajtime të reja, apo ofron të dhëna të reja për të përforcuar tezat ekzistuese në historiografinë shqiptare e më gjerë. Me të drejtë, autori argumenton se Federata Jugosllave i kishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë shqiptarët. Megjithëse, sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 1981, ata përbënin 7.7 për qind të popullsisë së përgjithshme të Jugosllavisë, pra ishin në përqindje më të lartë se maqedonasit dhe malazezët, atyre nuk i ishte njohur statusi i kombit konstitutiv, por ishin trajtuar si pakica kombëtare. Sikur të mos mjaftonte kjo, deri në Plenumin e Brioneve (1966), shqiptarët ishin mohuar shumë prej të drejtave të tyre kombëtare, trajtoheshin me përbuzje nga drejtuesit serbë, ishin keqtrajtuar në mënyrë sistematike dhe detyruar të shpërnguleshin në Turqi etj.

Monografia e prof. Krasniqit është një histori e Kosovës e parë në disa plane: në zhvillimet e brendshme ekonomike e politike të vetë Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës; raportet e saj me Federatën Jugosllave; Kosova në raport me shtetin-amë, Shqipërinë etj. Një risi interesante përbën në punim pasqyrimi i raporteve të shërbimeve të inteligjencës amerikane (CIA) mbi zhvillimet në Kosovë dhe, analiza që qarqet diplomatike perëndimore bënin mbi të ardhmen e Kosovës. Në analizën mbi zhvillimet politike, ekonomike, juridike në Kosovë autori thekson ndryshimet e ndodhura në Kosovë pas shkarkimit të Aleksandër Rankoviçit. Për një periudhë të shkurtër, Kosova arriti të shkëputet nga

dominimi i nacionalistëve serbë, gjë që mundësoi një zhvillim të vetëdijes dhe identitetit kombëtar të shqiptarëve.

Interesante janë edhe argumentet e sjella nga autori në punim për të mbështetur tezën se ndryshimet kushtetuese të ndodhura në Jugosllavi në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70, si dhe Kushtetuta e KSA të Kosovës ishin produkt i politikës së Josip Broz Titos për të ekuilibruar tendencat nacionaliste dhe unitariste të Serbisë, si një parakusht ky për të siguruar vijimësinë e Federatës Jugosllave edhe pas vdekjes së tij. Analiza e thelluar e Kushtetutës së KSA të Kosovës (1974), përdorimi i dokumenteve parësore jugosllave për të dëshmuar bisedimet në nivel federativ, por edhe shkallën e përfaqësimit të shqiptarëve në strukturat politike të Federatës Jugosllave, japin argumente të thelluara mbi këtë tezë. Për autorin, kjo Kushtetutë ishte zhgënjyese për serbët, të cilët humbën privilegjet historike në Kosovë, dhe reagues duke kundërshtuar ndryshimet kushtetuese dhe hartuar platforma nacionaliste (Libri i Kaltër) me qëllim zhbërjen e autonomisë së Kosovës. Ndryshimet kushtetuese nuk kënaqën plotësisht edhe pritshmëritë e shqiptarëve, të cilëve u dhanë të drejta përfaqësimi pothuajse të ngjashme me republikat përbërëse të Federatës, por pa iu njohur një status i tillë.

Autori bën një diferencim ndërmjet elitës politike komuniste të Kosovës dhe elitave të reja intelektuale. Ndërsa të parët përpiqeshin të përfitonin sa më shumë nga situata e krijuar në mënyrë që të anashkalonin strukturat qeverisëse serbe dhe të krijonin lidhje të drejtpërdrejta me kreun e Jugosllavisë, Titon, të dytët ishin më radikalë dhe kërkonin të avanconin kërkesat për më shumë të drejta kombëtare dhe një qartësim të statusit. Në këtë aspekt, me shumë interes është edhe analiza që i bën autori grupeve ilegale të krijuara në Kosovë në këtë periudhë.

Demonstratat e mars-prillit 1981, si ngjarjet që shenjua historinë e shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve '80 dhe u bënë preludi i zhvillimeve të mëvonshme për këtë krahinë, marrin në punim një vend qendror. Autori nuk ndalet të përshkruajë me detaje zhvillimet e demonstratave, për të cilat është shkruar jo pak. Ai ka zgjedhur një qasje më analitike duke tentuar të argumentojë disa teza interesante. Kështu, ai sjell tezën se, ndryshe nga sa pretendonin nacionalistët serbë, demonstratat e vitit 1981 ishin shprehje e reagimit të popullsisë së Kosovës kundrejt keqtrajtimit të vazhdueshëm të tyre nga nacionalistët serbë, vështirësive të theksuara ekonomike dhe pakënaqësisë së tyre për statusin juridiko-

kushtetues. Në mbështetje të kësaj teze, autori sjell statistika të shumta mbi dënimet e shqiptarëve në Jugosllavi, të cilat krahasuar me popullsinë e tjera që përbënin Federatën ishin më të larta. Në mbështetje të kësaj teze është edhe analiza e gjendjes ekonomike të Kosovës, kur autori, me të drejtë arrin në përfundimin se, ritmet e ulëta të zhvillimit ekonomik të Kosovës ishin rrjedhojë e drejtpërdrejtë e keqmenaxhimit të krahinës nga Republika e Serbisë.

Të gjitha këto burime, fakte dhe analiza argumentojnë mjaft mirë tezën se thirrjet e shqiptarëve gjatë demonstratave të prillit 1981 për shpalljen e Kosovës, Republikë, nuk kishin aspak synim të preknin rendin kushtetues të Federatës Jugosllave, aq më pak të cenonin tërësinë territoriale të saj, e cila, siç argumenton më së miri autori, mbrohej nga konfiguracioni gjeopolitik i kohës. Ato kërkesa paraqisnin të drejtën legjitime të shqiptarëve të Kosovës dhe, ashtu siç e tregoi koha, mosnjohja e kësaj të drejte ishte parakusht për destabilizimin e situatës dhe përshkallëzimin e konflikteve etnike.

E argumentuar është në punim edhe teza mbi rolin e Tiranës zyrtare në lidhje me demonstratat e mars-prillit të vitit 1981. Sipas autorit, rritja e kontakteve mes dy pjesëve të ndara të kombit, veçanërisht avancimi i marrëdhënieve kulturore, dërgimi i literaturës shqipe, zhvillimi i leksioneve nga profesorët e Universitetit të Tiranës për studentët e Universitetit të Prishtinës ndikoi në rritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Prof. Krasniqi pranon që së bashku me rritjen e vetëdijes kombëtare, Tirana zyrtare përçoi edhe modelin e saj të socializmit, por në punim ky aspekt konsiderohet si i një rëndësie dytësore.

Në këtë aspekt do të debatoja me kolegun Krasniqi, pasi në Shqipërinë e Hoxhës ishte imponuar një marrëdhënie simbiotike ndërmjet identitetit kombëtar dhe atij politik marksist-leninist. Pikërisht këtë model, Tirana zyrtare u përpoq ta ndiqte edhe në Kosovë. Drejtuesit e PPSH-së përpiqeshin të ndikonin në forcimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve të Kosovës, por ata njëkohësisht do të dëshironin që ata të përkrahnin dhe modelin e socializmit stalinist që zbatohet në Shqipëri. Vetëm një javë para shpërthimit të demonstratave, në një relacion të Drejtorisë së Jashtme të KQ të PPSH, ku diskutohet se cili prej grupeve ilegale në Kosovë duhej të gëzonte përkrahjen e qeverisë shqiptare, pasqyrohet qartë se këtë mbështetje do ta gëzonin ato grupe të cilat mbështesnin edhe modelin ideologjik të PPSH-së. Pavarësisht kësaj,

përfundimi i arritur në punim se përkrahja publike e qeverisë shqiptare për dhënien Kosovës, statusin e Republikës, ndikoi nga një anë për ndërkombëtarizimin e çështjes së shqiptarëve në Jugosllavi, por nga ana tjetër shtoi frikën e drejtuesve të lartë të Federatës për nxitje të “irredentizmit shqiptar” nga Tirana, gjë që ndikoi në marrjen e masave për kufizimin e statusit është një argument i logjikshëm.

Fakte dhe analiza interesante na sjell punimi edhe mbi procesin gjatë zhbërjes së statusit juridiko-kushtetues të Kosovës. Nacionalistët serbë të cilët humbën privilegjet në Kosovë, e përjetuan këtë proces si përpjekje të shqiptarëve për të eliminuar elementin serb në Kosovë. Prof. Krasniqi sjell argumente të shumta se si nacionalistët serbë përdorën hapësirat ligjore e kushtetuese, mediet jugosllave e ndërkombëtare, Kishën Ortodokse Serbe, kujtesën kolektive historike etj., për të krijuar imazhin e viktimizimit të serbëve nga shqiptarët “primitivë, barbarë dhe të pagdhendur”, pra duke përmbysur realitetin dhe akuzuar shqiptarët e viktimizuar historikisht nga nacionalistët serbë si agresorë.

Me shumë objektivitet dhe profesionalizëm është paraqitur në punim edhe roli i elitës politike shqiptare në ndryshimet kushtetuese që, praktikisht e zhbënë autonominë e fituar me Kushtetutën e 1974-s. Pas vdekjes së Titos dhe veçanërisht pas demonstratave të vitit 1981, elita e vjetër politike e Kosovës ose shkarkua nga funksionet që mbante, ose u pensionua. Jo të gjithë drejtuesit e rinj reagues ndaj presionit serb për të imponuar ndryshimet kushtetuese, të cilat do të çonin në abrogimin e autonomisë së krahinës. Autori dallon në këtë proces, kryetarin e KK të KSA të Kosovës Azem Vllasi, i cili reagoi ndaj fjalimit të Sllobodan Milosheviçit në Fushë-Kosovë. Prof. Krasniqi pranon se vetëm në vitet 1988-1989, një pjesë e elitës politike të Kosovës u grumbullua rreth dy politikanëve kryesorë të krahinës, Azem Vllasit dhe Katjusha Jasharit për të kundërshtuar ndryshimet kushtetuese të imponuara nga Serbia. Përkundëjt elitës politike autori vendos elitën intelektuale dhe masën e gjerë të popullsisë së Kosovës, të cilat reagues me anë të tubimeve masive kundër ndryshimeve kushtetuese duke kërkuar rivendosjen e Kushtetutës së 1974-s. Konsiderimi i këtyre tubimeve si armiçësore nga një pjesë e lidërshiptit politik të Kosovës, bëri që kërkesat e minatorëve të Trepçës të përfshinin largimin nga puna edhe të disa prej drejtuesve politikë të Kosovës.

Përtej vlerësimeve shumë pozitive për punimin, do të parashtroja edhe disa sugjerime. Kështu, do të sugjeroja një rishikim të strukturës së

punimit. Përfshirja e narrativës historike në kapituj, sythe e nënsythe mund ta orientonte më mirë lexuesin. Një strukturim më i mirë do të shmangte edhe përsëritje të panevojshme që hera-herës takohen në punim. Ndonjë titull mund të rishikohet dhe riformulohet për t'iu përshtatur më mirë përmbajtjes.

Gjithashtu, në parathënien e punimit, të cilin autori e ka konceptuar si një përsiatje mbi pozicionimin e shtetit shqiptar në kuadër të Luftës së Ftohtë, disa terma dhe fakte historike do të duhej të saktësoheshin. Kështu p.sh. autori flet për ndihma ekonomike që disa shtete perëndimore, midis të cilëve, Franca i dhanë Shqipërisë gjatë viteve 70-80. Në të vërtetë, termi i saktë do të ishte rritja e shkëmbimeve tregtare me vendet e Perëndimit. Do të tërhiqja vëmendjen e kolegut Krasniqi për disa teza që ai parashtron në punim. Kështu p.sh. teza se Shqipëria pas daljes nga Pakti i Varshavës u bë subjekt ndërkombëtar dhe interesat e saj merreshin në konsideratë nga ShBA dhe BRSS, mendoj se ka nevojë për argumentim të mëtejshëm. Roli i Shqipërisë në zhvillimet në Ballkan merrej në konsideratë në analizat politike dhe diplomatike të të dy superfuqive, por mendoj se pas Konferencës së Helsinkit dhe ftohjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me Kinën, pozicioni i Shqipërisë në koniunkturat gjeopolitike nuk erdhi duke u përforcuar, përkundrazi. Për më tepër, presioni i Perëndimit në lidhje me shkeljen e të drejtave në Shqipëri e vinte diplomacinë shqiptare në një pozitë jo të favorshme për të ngritur zërin për shqiptarët e Jugosllavisë.

Në përfundim, mendoj që një punim i arrirë shkencor është ai që në mënyrë figurative të hap mendjen dhe të bën të reflektosh mbi njohuritë e tua të deritanishme. Mendoj se historia e Kosovës e kolegut Krasniqi sjell burime të reja të panjohura më parë, të cilat janë një ftesë për të vijuar debatin shkencor mbi këtë temë.

*Tiranë, më 6 tetor 2021*

**Prof. assoc. dr. Sonila Boçi**

